

		REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR		MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	01-M	Nr.Prot: Broj.Prot: Prot.No	1950/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-09-	Data: Datum: Date	16/09/2026
PRISHTINË/A			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning*

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

MINISTRISË SË MJEDISIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

PËR PASTRIMIN DHE MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË LUMENJVE  
NDËRKUFITARË, ME FOKUS NË LUMIN DRIN

### Preambula

Ministria e Mjedisit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës,

Me dëshirën për të zhvilluar dhe intensifikuar bashkëpunimin në fushën e mjedisit midis dy vendeve;

Duke njohur rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve dhe biodiversitetit midis dy vendeve;

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendet e tyre respektive dhe detyrimet që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare dhe të Evropës;

Palët kanë rënë dakord për sa vijon:

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është të forcojë bashkëpunimin institucional ndërmjet Palëve për menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm të segmentit ndërkufitar të Lumit Drin, me synim:

- Mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave
- Parandalimin dhe reduktimin e ndotjes ndërkufitare
- Ruajtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit
- Promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore

## **Neni 2**

### **Fusha e Zbatimit**

Ky Memorandum zbatohet në segmentet ndërkufitare të Lumit Drin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, si dhe në zonat që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe regjimin e tij hidrologjik.

## **Neni 3**

### **Parimet Udhëzuese**

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Menaxhimi i integruar i burimeve ujore
- Parimi i parandalimit dhe i kujdesit paraprak
- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe shkëmbimi i informacionit
- Transparenca dhe përfshirja e publikut

## **Neni 4**

### **Fushat e Bashkëpunimit**

Palët do të bashkëpunojnë, ndër të tjera, në:

- Monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave
- Identifikimin dhe adresimin e burimeve të ndotjes
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për pastrimin e lumit
- Shkëmbimin e të dhënave dhe ekspertizës teknike
- Ndërtimin e kapaciteteve institucionale

## **Neni 5**

### **Mekanizmat Institucionalë**

Për zbatimin e këtij Memorandumi, Palët bien dakord të:

- Themelojnë një Grup të Përbashkët Pune Shqipëri–Kosovë për Lumin Drin;
- Hartojnë plane të përbashkëta veprimi;
- Organizojnë takime periodike në nivel teknik dhe politik.

## **Neni 6**

### **Financimi**

Çdo aktivitet bashkëpunimi, që rrjedh nga ky Memorandum, do të zbatohet me qëllim të forcimit të bashkëpunimit institucional ndërmjet Palëve për menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm të segmentit ndërkufitar të Lumit Drin.

Detyrimet financiare që mund të lindin nga zbatimi i këtij Memorandumi, do të trajtohen në kuadër të buxheteve vjetore të zakonshme të dy Ministrive, duke iu nënshtuar legjislacioneve të brendshme përkatëse.

## **Neni 7**

### **Integrimi Evropian**

Palët angazhohen që bashkëpunimi në kuadër të këtij Memorandumi të kontribuojë në avancimin e procesit të integrimit evropian për kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, nëpërmjet:

- Përafrimit të legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit dhe ujërave
- Zbatimit të Direktivës Kuadër për Ujërat dhe instrumenteve të tjera përkatëse
- Pjesëmarrjes në programe dhe iniciativa ndërkufitare të mbështetura nga Bashkimi Evropian
- Shkëmbimit të praktikave më të mira evropiane

## **Neni 8**

### **Statusi Juridik**

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk krijon detyrime juridike ndërkombëtare dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të secilës Palë.

**Neni 9**  
**Ndryshimi i Memorandumit**

Ky Memorandum mund të ndryshohet ose modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë, nëpërmjet njoftimit me shkrim të Palëve. Ndryshimi ose modifikimi do të jetë pjesë thelbësore e Memorandumit dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

**Neni 10**  
**Hyrja në Fuqi dhe Kohëzgjatja**

1. Ky memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit.
2. Ky memorandum nënshkruhet për një periudhë prej 5 vitesh dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë tjetër 5-vjeçare, në rast se Palët nuk njoftojnë me shkrim kërkesën për tërheqjen nga Memorandumi, por jo më vonë se 3 muaj para mbarimit të periudhës.
3. Ky memorandum mund të ndryshohet ose të shtohet në çdo moment nëpërmjet një dakortësimi me shkrim mes Palëve. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe do të përfshihet këtu me referencë.
4. Pa cënuar dispozitën e paragrafit 2 të këtij neni, dispozitat e memorandumit do të vijojnë të zbatohen për projekte dhe aktivitete ekzistuese deri në përfundim, në rast se nuk dakortësohet ndryshe nga Palët.


**Neni 11**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mospajtimet që mund të lindin mes Palëve për shkak të interpretimit apo zbatimit të dispozitave të këtij Memorandum do të zgjidhen nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta mes Palëve nënshkruese përmes kanaleve diplomatike.

Për sa më sipër, të nënshkruarit, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi në *Tiranë*, në datë *03.02* 2026, në gjuhën shqipe.

Për Ministrinë e Mjedisit

Ministri përgjegjës për mjedisin  
Emri: Z.Sofjan JAUPAJ  
Nënshkrimi:



Për Ministrinë e Mjedisit dhe  
Planifikimit Hapësinor

Ministri përgjegjës për mjedisin  
Emri: Znj. Fitore PACOLLI DALIPI  
Nënshkrimi:

